

Mjedise 100% PA DUHAN

Ambientet 100% pa duhan janë mënyra e vetme për të mbrojtur shëndetin e njerëzve nga rreziqet e duhanpirjes pasive.

Tymi i duhanit përmban mbi 4.000 kimikate, nga të cilat rreth 50 janë substanca kancerogjene. Ai është i dëmshëm si për duhanpirësit edhe për jo-duhanpirësit ose për duhanpirësit pasivë.

Rreziqet e duhanpirjes pasive

Duhanpirja pasive ka efekte afatshkurtëra dhe efekte afatgjata në shëndet:

- Ajo përkeqëson gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe krijon gjendje të reja shëndetësore.
- Substancat që çlirohen nga tymi i duhanit shkaktajnë kancer ose ndihmojnë në zhvillimin e kancerit:
 - a. Rritin rrezikun e zhvillimit të kancerit të mushkërive me 25% - 30%
 - b. Ndihmojnë në zhvillimin e kancereve të tjera, si: kancerit të gjirit, laringsit, fytit
- Rrit me 50% rrezikun për sëmundje të zemrës
- Dyfishon rrezikun e aksidenteve vaskulare
- Duhanpirja pasive tek gratë shtatzëna ka efekte mutagjenike, sepse të gjitha substancat toksike kalojnë tek fëmija përmes placentës; rrit shtrimet në spital të nënës, lindjet e parakohshme ose lindjet e fëmijëve me peshë të vogël
- Duhanpirja pasive ka mjaft efekte negative në shëndetin e fëmijëve, që lidhen si me duhanpirjen pasive para lindjes ashtu edhe mbas lindjes:
 - a. Rrit frekuencën e infeksioneve të veshit, hundës, fytit;
 - b. Rrit rrezikun për kriza të astmës dhe të infeksioneve respiratore si pneumonia
 - c. Shkakton reduktim të rëndësishëm në zhvillimin e mushkërive
 - d. Rrit rrezikun e vdekjes së papritur të foshnjave (vdekje në krevat)
 - e. Janë më të prirur të kenë probleme me të mësuarin

Vetëm mjediset 100% pa duhan mbrojnë shëndetin e njerëzve nga rreziqet e duhanpirjes pasive.

Duhanpirja aktive dhe pasive është rrezik për shëndetin

Ligji Nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”, parashikon ndalimin e duhanpirjes në:

- a) mjediset e punës;
- b) institucionet shëndetësore, me përjashtim të institucioneve të shëndetit mendor (vetëm për pacientët);
- c) institucionet arsimore, përfshirë dhe çerdhet;
- ç) mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë;
- d) mjediset e mbyllura tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës;
- dh) mjediset e mbyllura kulturore e sportive;
- e) mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;
- ë) mjediset e tjera publike të mbyllura

Konsumimi i duhanit në mjediset e mësipërme do të shoqërohet me masa administrative (gjoba) si më poshtë:

- 300 000 (treqind mijë) lekë, subjekti i tatueshëm;
- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;
- 50000 (pesëdhjetë mijë) lekë, administratori në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;
- **Kujdes!** Tani dënohet edhe duhanpirësi që nuk respekton ligjin me vlerën **5.000** (pesëmijë) lekë

Për kontrollin e zbatimit të ligjit do të ketë bashkëpunim të shumë institucioneve shtetërore, të tilla si: inspektoratet që mbulojnë fushën e shëndetit, të punës, të arsimit, inspektorati i sigurisë ndaj zjarrit, organet e administratës doganore dhe tatimore, policia e shtetit, policia bashkiake/komunare, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, etj.

Ju kërkohet njohjen dhe zbatimin e ligjit dhe Ju sigurojmë se të gjitha subjektet do të jenë të barabartë para ligjit. Askush nuk do të jete i mbrojtur nga moszbatimi i ligjit.

Qytetarë! Ju lutemi na informoni për rastet e shkeljeve të ligjit anti-duhan në këtë numër telefoni: 0800 4040.

Duke zbatuar ligjin - Mbroni veten dhe fëmijët nga rreziqet në shëndet.

Ta bëjmë duhanpirjen shoqërisht të papranueshme

Ju faleminderit!

Ministria e Shëndetësisë

Instituti i Shëndetit Publik